



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik

PROCESVERBAL

Tiranë, më 01.02.2021, ora 9:00

Drejton mbledhjen:

Ramazan Gjuzi – kryetar i Komisionit

Rend i ditës:

- Miratimi i procesverbaleve të datave 25 dhe 26 janar 2021.
- Vendime të Komisionit për rishpalljen e procedurës së përzgjedhjes së 3 anëtarëve të Këshillit Drejtues të RTSH-së. Vendimet nr. 3, 4 dhe 5/2021.

Marrin pjesë:

Ramazan Gjuzi, Mirela Kumbaro, Fidel Ylli, Musa Ulqini, Vilma Bello, Ismet Beqiraj, Fadil Nasufi, Adelina Rista, Bujar Çela, Almira Xhembulla, Lindita Nikolla, Klajdi Qama, Kostaq Papa, Selami Jenishehri.

Mungojnë:

Enada Kapllani, Fatjona Dhimitri, Amra Barova dhe Erion Piciri.

HAPET MBLEDHJA

Ramazan Gjuzi – Mirëmëngjesi të gjithëve!

Fillojmë mbledhjen e Komisionit për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik me këtë rend dite: Miratimi i procesverbaleve të datave 25 dhe 26 janar 2021 dhe shqyrtimi i vendimeve të komisionit për rishpalljen e procedurës së përzgjedhjes së tre anëtarëve të Këshillit Drejtues të Radiotelevizionit Publik Shqiptar, pas rrëzimit të tri kandidaturave në seancën e fundit plenare.

Para se të fillojmë, verifikojmë prezencën.

Mirela Kumbaro?

Mirela Kumbaro – Këtu. Mirëmëngjesi!

Ramazan Gjuzi – Mirëmëngjesi!

Fidel Ylli?

Fidel Ylli – Këtu.

Ramazan Gjuzi – Mirëmëngjesi!

Musa Ulqini?

Musa Ulqini – Present.

Ramazan Gjuzi – Mirëmëngjesi!

Vilma Bello?

Vilma Bello – Mirëmëngjesi! Po, këtu.

Ramazan Gjuzi – Ismet Beqiraj?

Ismet Beqiraj – Këtu.

Ramazan Gjuzi – Fadil Nasufi?

Fadil Nasufi – Këtu.

Ramazan Gjuzi – Adelina Rista? Prezente.

Bujar Çela? Present.

Almira Xhembulla? Prezente.

Mirela Kumbaro – Lindita po më shkruan në *Whatsapp* që nuk po arrin të futet dot në linjë, por është.

Ramazan Gjuzi – Enada Kapllani? Fatjona Dhimitri? Mungojnë.

Klajdi Qama?

Klajdi Qama – Present.

Ramazan Gjuzi – Kostaq Papa? Present.

Selami Jenishehri?

Selami Jenishehri – Prezent.

Ramazan Gjuzi – Amra Barova? Erion Piciri? Mungojnë.

Atëherë, numri plotësohet.

Fillojmë me miratimin e procesverbaleve të datave 25 dhe 26 janar 2020.

Kush është dakord? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Meqenëse tri kandidaturat për vendet vakante në KDRTSH në seancën e mëparshme u rrëzuan nga Kuvendi, rihapim garën për këto tre vende vakante. Lexojmë një nga projektvendimet, se janë të tre njëloj: “Për rishpalljen e procedurës së përzgjedhjes së një anëtari të Këshillit Drejtues të Radiotelevizionit Shqiptar”. Me vendimet nr. 3, 4 dhe 5, në mbështetje të nenit 93, pika 2, dhe nenit 94, pika 2, të ligjit nr. 97/2013 “Për mediet audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe bazuar në nenin 34 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik vendos rishpalljen e një vendi vakant për anëtar të Këshillit Drejtues të Radiotelevizionit Shqiptar. Të ftohen për paraqitjen e kandidaturave për anëtarë të Këshillit Drejtues të RTSH-së subjektet e mëposhtme: shoqatat dhe grupimet e mediejeve elektronike; shoqatat e medias së shkruar; profesorati dhe shoqatat e inxhinierisë elektrike dhe elektronike; profesorati i të drejtës, gazetarisë, komunikimit dhe ekonomisë; shoqatat e juristëve dhe Dhomën Kombëtare të Avokatisë; organizatat jofitimprurëse që veprojnë në fushën e të drejtave të njeriut, të drejtat e fëmijëve dhe kërkimet në politikat publike ose përfaqësuese; shoqatat që veprojnë në fushën e mbrojtjes së personave me aftësi të kufizuara.

Shërbimet e Kuvendit të bëjnë publike vakancat në faqen zyrtare të Kuvendit. Në shpallje të përcaktohet edhe dokumentacioni që duhet të shoqërojë propozimin e kandidaturës nga subjektet e sipërpërmendura, për vlerësimin e përmbushjes së kritereve ligjore. Afati i paraqitjes së kandidaturave të propozuara, shoqëruar me dokumentacionin përkatës, përfundon 20 ditë nga data e publikimit të këtij vendimi.

Kush është dakord me vendimin nr. 3? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Kush është dakord me vendimin nr. 4? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Kush është dakord me vendimin nr. 5? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Po, zoti Papa.

Kostaq Papa – Dua të them jo vetëm për tre pozicionet e mbetura bosh, por kam përshtypjen se nga sot duhet të fillojë një maratonë e madhe për zëvendësimin e të gjitha vendeve vakante në Këshillin Drejtues të Radiotelevizionit, si organi kryesor i medias publike, i cili përcjell mesazhe për shqiptarët brenda dhe jashtë Shqipërisë.

Kemi mungesë jo vetëm për tre vendet vakante që u rrëzuan në seancën e kaluar apo që kanë ngelur bosh nga vitet e mëparshme, por duhet të zëvendësohen të gjitha vakancat, në mënyrë që Radiotelevizioni Publik Shqiptar të ketë mbarësi në veprimtarinë e tij.

Faleminderit!

Ramazan Gjuzi – Faleminderit!

Ditën e mërkurë do të fillojmë me mbledhjen maratonë.

Ka diçka tjetër? Nuk ka.

Mbledhjen e deklaroj të mbyllur.

Ditën e mirë dhe shihemi në seancë!

MBYLLET MBLEDHJA